

MARENGLLEN VERLI**VEPRIMTARIA DIPLOMATIKE E HASAN PRISHTINËS
PËR ÇËSHTJEN E KOSOVËS***

Hasan Prishtina është një ndër personalitetet më të spikatur të Kosovës e të mbarë Shqipërisë me kontribut të veçantë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, i angazhuar si rrallëkush për arritjen e autonomisë dhe pavarësisë së Shqipërisë në kufijtë e natyrshëm etnikë¹.

Veprimtaria intensive në të mirë të çështjes kombëtare në parlamentin osman (3 herë deputet / 1908-1912) në median e kohës, pranë përfaqësive të huaja diplomatike dhe në Komitetin Shqiptar të Stambollit, për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve, për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës kombëtare etj., si edhe roli drejtues në organizimin e Kryengritjes Antiosmane në Kosovë në vitin 1912, e vendosën Hasan Prishtinën qysh në fund të dekadës së parë të shek.XX, në krye të Lëvizjes Kombëtare por edhe në Kosovë². Për këtë arsye ai konsiderohej person “non grata” për Portën e Lartë, por edhe për qarqet drejtuese të Serbisë, që kishin thurur planet për aneksimin e viseve shqiptare dhe që për ta neutralizuar e internuan në Beograd në dimrin e viteve 1912-1913, por, për këtë arsye edhe u mirëprit në korrikun e vitit 1913 në Vlorë dhe u ngarkua me detyrën e ministrit (të Bujqësisë) në Qeverinë Kombëtare të Ismail Qemalit³.

Por çështja e çlirimit të Kosovës nga pushtimi serbo-malazez pas vendimit arbitrar të Konferencës së Londrës, do të bëhej preokupimi kryesor i jetës së Hasan Prishtinës. Ai në dimrin e viteve 1913-1914 në kërkim të mjeteve dhe armëve për të ndezur kryengritjen në Kosovë iu afrua Esat Toptanit, mandej, pas shpërthimit më 8 korrik të luftës midis Austro-Hungarisë dhe Serbisë edhe pse ndeshi në kundërshtimin e qeverisë së Vidit, Turhan Pashës, që kishte frikë se me largimin e rreth 500 kosovarëve e dibranëve do të

* Kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor “Ditët e Hasan Prishtinës”, mbajtur më 7 tetor 2009 në Vushtri (Kosovë), me organizim nga Ministria për Kulturë, Rini e Sporte dhe Ministria për Arsim, Shkencë e Teknologji e Republikës së Kosovës.

¹ *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* (më tej: *FESH*), Tiranë, 1985, zëri “Prishtina, Hasan (1873-1933)”.

² *Hasan Prishtina (përmbledhje dokumentesh 1908-1934)*, përgatitur nga K.Nuro, N.Bato, Tiranë: 1983, dok.1-43.

³ *Po aty*, dok. 45, 46.

dobësohej mbrojtja e Durrësit përballë rebelëve të Shqipërisë së Mesme), u impenjua për goditjen dhe sprapsjet e serbëve përtej “kufirit strategjik” të vendosur prej tyre në bregun e Drinit, brenda kufirit të njohur të Shqipërisë, si dhe për rigjallërimin e kryengritjes në Kosovë⁴, kurse më 1917 për çlirimin e viseve shqiptare nën sundimin bullgar⁵. Gjithnjë për të njëjtën arsye H.Prishtina do t’i ndihmonte austro-hungarezët për dy vjet me radhë por edhe do t’u kundërvihej në vitin 1918, në situatën e re ndërkombëtare që po përvijohet me afrimin e dukshëm të fundit të Luftës së Parë Botërore dhe që diktonte ndërtimin e një strategjie të re për t’u renditur përkrah fitimtarëve⁶.

H.Prishtina edhe më pas do të ishte në krye të atdhetarëve që nuk i përjashtuan kurrë në mos i preferuan veprimet radikale për çlirimin e Kosovës. Përfaqësues kryesor i këtij grupimi brenda Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, ai do të ishte nxitësi kryesor i krijimit, organizimit dhe ndërgjegjësimit të çetave kryengritëse antiserbe (apo antijugosllave) në Kosovë e më gjerë pas vitit 1918, i shpërthimit të kryengritjes së fuqishme të Rrafshit të Dukagjinit dhe Drenicës në pranverën e vitit 1919, i përqendrimit të rreth 2000 kryengritësve kosovarë në Zonën Neutrale të Junikut në vitet 1921-23, për t’i ruajtur nga asgjësimi dhe i pjesëmarrjes së kryengritësve kosovarë përkrah opozitës në ngjarjet e vitit 1924 me fitoren e së cilës shpeshohej angazhimi më aktiv i shtetit shqiptar në të mirë të zgjidhjes së çështjes së Kosovës⁷. Por H.Prishtina sa ishte njeriu i veprimeve radikale me armë për çlirimin e Kosovës

⁴ *FESH*, vëll.III, Tiranë: 2009. Në qeverinë e parë të Princ Vidit të kryesuar nga Turhan Pasha, 17 mars -27 maj 1914, H.Prishtina pati postin e ministrit të Postë-Telegrafëve. Pasi për mungesë fondesh propozimi i tij për t’u kredituar vendosja e emigrantëve kosovarë në Shqipëri, nuk u miratua, ai duke përfituar nga shpërthimi i luftës midis Austro-Hungarisë dhe Serbisë u përpoq të organizonte luftën për çlirimin e viseve të okupuara nga Serbia dhe Mali i Zi, në trevat verilindore e lindore brenda e jashtë kufirit të njohur Shqipërisë. Në këtë aksion bashkëpunoi me Bajram Currin, Isa Boletinin, Selim Vatushën, Bajram Daklanin, Qerim Begollin, Halim Derhallën dhe përfaqësues të tjerë të parisë së viseve të Kosovës e të Dibrës.

⁵ *Hasan Prishtina ...*, dok.50-56. I arrestuar nga bullgarët, H.Prishtina mundi të arratiset nga burgu i Shkupit dhe të kalonte në zonën austro-hungareze të pushtimit në dhjetor 1917.

⁶ Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina në lëvizjen kombëtare e demokratike shqiptare (1908-1933)*, Prishtinë: 1990. H.Prishtina ndihmoi në ngritjen e administratës së shkollave etj. në Kosovë, por edhe në rekrutimin e shqiptarëve atje për llogari të austro-hungarezëve. Në vitin 1918 ishte për orientim nga fituesit si e vetmja mundësi për të përballuar dhunën e Serbisë të rreshtuar me Antantën.

⁷ Limon Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë*, Prishtinë, 1981; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2007; etj.

ishite edhe njeriu i angazhimeve diplomatike, deri në plan rajonal e ndërkombëtar.

Qysh në vitet 1908-1912 ai u përpoq t'i hapë sytë parlamentit osman (14 dhe 21.03 (3.04) 1910 etj.) për rrezikun që u vinte nga Serbia kufijve veriorë të shtetit ku shtriheshin viset shqiptare, dhe për nevojën e ndaljes së dhunës ushtarake kundër shqiptarëve, të mirëqeverisjes e të plotësimit të kërkesave të tyre kombëtare për bashkim administrativ, autonomi, arsim në gjuhën amtare etj.⁸ Në krye të kryengritësve shqiptarë, ai, më 21 korrik-9 gusht 1912, negocioi me përfaqësuesit e Stambollit për aprovimin e 14 pikave historike që praktikisht i siguronin autonominë Shqipërisë⁹.

⁸ T. Abdyl, *vep. e përm.*, f.40-49.

⁹ H. Prishtina, *Një shkurtim kujtimesh*, botim i dytë, Bari: 1925, f.32. Sipas këtyre kujtimeve në bisedimet me komisionin e qeverisë osmane, më 25 korrik 1912, kërkesat mund të përmbledheshin në katër pika: 1 - Të njiheshin zyrtarisht kufijtë e Shqipërisë; 2 - Autoritetet civile e ushtarake në Shqipëri ishin të kombësisë shqiptare; 3 - Ushtarakët shqiptarë të shërbenin në Shqipëri e të komandoheshin prej oficerësh shqiptarë; 4 - Veprimet zyrtare në Shqipëri të bëheshin në gjuhën shqipe. Nga Kuvendi shqiptar i Ferizajt më 6 gusht 1912 H. Prishtina i paraqiti përfaqësuesit osman Ibrahim Pashës një memorandum me 14 kërkesa: 1. Me përdorue në Shqypni nëpunës të praktikuem qi dijnë gjuhën e zakonet e vendit; 2. Me ba shërbimin ushtarak vetëm në Shqypni e Makedoni, për jashta kohës së luftës; 3. Me bâ e me vu në zbatim ligjë tue u bazue në ligjen e maleve (xhibal) për disa krahina në të cilat është forcue me fakte se nuk mund të nxierret kurrnji fryt prej organizimit të drejtsis; 4. Me i dhânë shqyptarëve armët e nevojshme e moderne; mënyra e të damit të cilave do t'i përkitte Qeveris (Do t'u bajshin ndewr vende të randësishëm deposita armësh të cilat, në rasë të nevojës, do të mund t'i merrshin shqyptarët); 5. Me themelue e me hapë shkolla reale në të gjitha Prefekturat e qândrave të Kosovës, të Monastirit, të Shkodrës e të Janinës qi numronjnë ka një popullsi ma se 300.000 frymësh; me hapë edhe shkolla bujqsije si të Salonikut, mbasi vendi me krejt kuptimin është një vende bujqësi; si edhe me shti në program të mësimëve gjuhën e vendit; 6. Me hapë shkolla theologjike modern ndër vende ku është nevoja; 7. Me kenë i lirëshem në Shqypni të hapunit e të themeluemit e shkollave private; 8. Me u mësue gjuha e vendit në shkollat fillestare, qytetse e në gjymnaze; 9. Me i dhânë randsi të posaçme tregtis, bujqsis e punve botore si edhe me plotsue e me perhapse udhët e hekurit; 10. Me vu në veprim organizimin e krahinave; 11. Me u kujdesue me ruejtë mâ fort se përpara zakonet e tradicjonet komtare; 12. Me çpallë amnistin (faljen e përgjithshme), pa veshtrue klasë e race, për të gjitha othomanët që kanë marrë pjesë në kryengritje, për komandantat, oficerat, nëpunësit e ushtarët që kanë lanë ushtrit e vendet e veta si edhe për të liruemit e t'ikunit prej burgut në kohën e kryengritjes; 13. Me u dhanë çdamim, mbas çmimit të vërtetë, prej Qeveris Turke për të gjitha ato shpija që u prishem mâ para e nuk u kje dhanë të zotve çdamimi si edhe për ata që u prishen e u rrenua kësaj here; 14. Me i marrë në gjyq të naltë pjestarët e kabinetëve të Haki e të Sait Pashës".

Në botimin e këtyre kërkesave Hasan Prishtina për pikën 10 ka dhënë këtë shpjegim: "Këto janë propozime për me diftue kufijt e Shqypnis heshtimisht

Në vitet e Luftës së Parë Botërore H.Prishtina u përpoq në rrafshin e diplomacisë të bënte më të mirën për zgjidhjen e çështjes të porsakrijuar të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të copëtuara më 1913-ën, ashtu siç ishte përpjekur më parë për autonominë dhe pavarësinë e Shqipërisë etnike. Duke përfutur nga prania e forcave austro-hungareze në Kosovë, dhe përgjithësisht nga qëndrimi i favorshëm disavjeçar i Perandorisë Habsburge ndaj shqiptarëve, H.Prishtina nga fundi i nëntorit të vitit 1916, i drejtoi një lutje Komandës së Korparmatës XIX të ushtrisë austro-hungareze të dislokuar në viset shqiptare, ku ndër të tjera propozonte që Kosova dhe viset e tjera shqiptare të bashkoheshin me territoret e administratës austro-hungareze në Shqipëri.¹⁰ Njëherësh, në bashkëpunim me intelektualë kosovarë të kohës, të inkuadruar në shoqërinë legale politike, kulturore, arsimore “Bashkimi” (të cilën e formoi vetë që nga fundi i vitit 1915) dhe ilegalisht në komitetin e fshehtë të quajtur “Komiteti i Kosovës” ndihmoi përgatitjen e një “harte etnike të shqiptarëve” të destinuar për t’ua paraqitur Fuqive të Mëdha.¹¹ Më pas, më 18 dhjetor të vitit 1918, kur përgatitej të hapte siparin Konferenca e Paqes e Parisit, dhe kur ende nuk ishte krijuar një qeveri shqiptare përfaqësuese (u krijua pas mbledhjes së Kongresit të Durrësit më 25 dhjetor 1918), H.Prishtina i adresoi një telegram Presidentit të SHBA, Uillson, që t’u jepej një zgjidhje e drejtë kërkesave të ligjshme të popullit shqiptar¹². “Në këtë çast solemn, shkruante ai, ne, përfaqësues të dy milionë e gjysmë shqiptarëve të popullit më të vjetër të gadishullit të Ballkanit ... ju lutemi të shqyrtoni aspiratat e kombit tonë ..., të ushtroni ndikimin tuaj me qëllim që gjatë negociatave lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me të ardhmen e Shqipërisë, të thirret të marrë pjesë në Konferencën e Paqes një delegacion i popullit shqiptar për të parashtruar dhe argumentuar aspiratat dhe kërkesat e kombit shqiptar”¹³.

Në këtë periudhë të turbullt të Pasluftës së Parë Botërore, në kuadër të sensibilizimit të kancelarive të Fuqive të Mëdha vendimmarrëse dhe të opinionit ndërkombëtar për çështjen e Kosovës dhe çështjen shqiptare në përgjithësi, H.Prishtina, kudo që u ndodh nuk mungoi të informonte bashkëpunëtorët dhe miqtë e tij të pranishëm në kryeqytetet evropiane për situatën në Shqipëri e në Kosovë, si edhe t’i këshillonte si të vepronin për të

(tacitement). Me folë kjarisht për caktimin e kufive të Shqypnis u donte të vrahemi me Riza Begun” (H. Prishtina, *vep. e përm.*, f.34-36.)

¹⁰ *Hasan Prishtina...*, dok.55.

¹¹ T.Abdyli, *vep. e përm.*, f. 206.

¹² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi 251, dos.9, fl.122. Telegram i H.Prishtinës drejtuar presidentit të SHBA, Uillson, në Paris, dt. 18.12.1918.

¹³ *Po aty*.

publikuar sa më mirë çështjen shqiptare¹⁴. Në një telegram dërguar nga Roma Sotir Kolesë, më 29 janar 1919, ai duke nënshkruar në emër të “shqiptarëve të Kosovës”, i kërkonte bashkatdhetarit të tij që bashkë me të tjerë të përpiqeshin me të gjitha forcat që “shqiptarët e Kosovës të ribashkohen me të gjithë shqiptarët në një shtet të pavarur e të lirë”. Në këtë moment historik [kur Konferenca e Paqes do të vendosë ..., shkruante H.Prishtina, ju lutemi mos harroni shqiptarët e Kosovës që kanë vuajtur më shumë për idealin tonë kombëtar ... Dëshira e tyre e zjarrtë është bashkimi me të gjithë shqiptarët në një atdhe të lirë ...?]¹⁵.

Për peshën e personalitetit që kishte dhe për veprimtarinë konsekuente patriotike, në dhjetor të vitit 1919, Komiteti “MKK” e vendosi H.Prishtinën, këtë anëtar të rëndësishëm të vetin qysh prej themelimit, në krye të delegacionit që dërgoi në Konferencën e Paqes për të kërkuar bashkimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare të përfshira në Jugosllavi me Shqipërinë. I penguar në kryerjen e kësaj detyre dhe i zhgënjyer nga mungesa e mirëkuptimit kolektiv të këtij forumi, por edhe nga politika italiane, që po rrezikonte edhe Shqipërinë e 1913-ës, H.Prishtina, përmes një aksioni të bashkërenduar me kundërshtarët e regjimit të Beogradit, në kundërshtim me qëndrimin e qeverisë së Tiranës, u përpoq të siguronte armë për një kryengritje në Dibër e Kosovë që llogaritej të shndërrohej në një luftë çlirimtare e në një përmbysje demokratike për gjithë Jugosllavinë. Për këtë qëllim u lidh edhe me Gabriel d’Anuncion (Gabriele d’Annunzio) në verën e vitit 1920 dhe, në vjeshtën e vitit 1923 edhe me disa deputetë italianë që i prematuan përkrahje diplomatike dhe armë. Ndonëse d’Anuncio dhe të tjerët interesoheshin për nxitjen e çdo konflikti në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene që do t’i jepte mundësi Italisë të aneksonte Fiumen dhe më pas të mbetej një shtet i destabilizuar dhe rival i dobët i Italisë, H.Prishtina e shikonte çështjen nga aspekti i interesave shqiptare¹⁶. Akordi me d’Anuncion ndodhi pikërisht në momentin kur H.Prishtina ndihmoi në organizimin e kryengritjes antiserbe në Dibër dhe në riorganizimin e Komitetit “MKK” nën

¹⁴ *Po aty*, Fondi 54, dos.67/1, fl.166-167. Letër e H.Prishtinës drejtuar Sotir Kolesë në Zvicër, ku i rekomandon botimin e shpesh të gazetës “L’Albania”, ose përfitimin e shërbimeve për çështjen shqiptare të një gazete të rëndësishme të huaj.

¹⁵ *Po aty*, Fondi 54, dos.67/1, fl.169. Telegram i H.Prishtinës, dt. 29.01.1919 dërguar nga Roma Sotir Kolesë.

¹⁶ *Po aty*, Fondi 822, dos.28/2, fl.40-41. Letër e H.Prishtinës drejtuar nga Roma Hoxhë Kadrisë me 16.6.1920; *po aty*, Fondi 818, dos.8/1, fl.206-208. Letër e H.Prishtinës dt. 2 nëntor 1923, dërguar B.Currit ku e njoftonte se kishte marrë premtim nga disa deputetë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Jashtme për përkrahje diplomatike dhe me armatime. Shih edhe *FESH*, vëll.III, Tiranë: 2009, art. “Hasan Prishtina”; T.Abdyli, *vep. e për.*, f. 229, 247, G.d’Anuncio ishte frymëzues i Komitetit irredentist të shqiptarëve, bullgarëve, malazezëve, kroatëve, hungarezëve, vojvodinasve.

emrin “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës dhe e Dibrës”, programi themeltar i të cilit u miratua më 30 gusht 1920.¹⁷

Kundërshtimi i Tiranës zyrtare në gusht-shtator 1920, për të lejuar zbarkimin e armëve italiane në bregdetin shqiptar (Shëngjin) e hodhi H.Prishtinën në një opozitë pa kthim ndaj grupimit politik që qeveriste në Tiranë, deri në qershor të vitit 1924¹⁸. Eksponent me peshë në politikën shqiptare të gjysmës së parë të viteve 20, si deputet dhe si kryeministër (për 7 ditë) në dhjetorin e vitit 1921, apo si person i nxjerrë jashtë ligjit gjatë viteve 1922-23, ai nuk reshti së përpjekuri për të mbajtur gjallë qëndresën në Kosovë, për të sensibilizuar opinionin në Shqipëri për çështjen e Kosovës por edhe të Çamërisë (shih diskutime të vitit 1921 në Këshillin Kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve jashtë kufijve të Shqipërisë, përkrahjen ekonomike të emigrantëve kosovarë, shkollimin e fëmijëve të tyre në Shqipëri etj.)¹⁹ për të denoncuar e dënuar rektifikimet e reja kufitare në favor të Jugosllavisë dhe shkaktarët e tyre²⁰, dhe për të sjellë në pushtet në Shqipëri opozitën demokratike.

Prania impresionuese e Hasan Prishtinës në skenën e politikës në Shqipëri dhe veprimtaria e pareshtur për zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës, përcaktuan vlerësimin e Hasan Prishtinës si faktor të paneglizhueshëm në kuadër të elitës politike shqiptare, por ... të politikës

¹⁷ Lush Culaj, *Komiteti “MKK”*, Prishtinë: 2006, f.32; Zamir Shtylla, “Rreth krijimit dhe veprimtarisë së Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës””, në *Studime historike*, nr.3, Tiranë, 1986. Programin themelor përbëhet prej 3 neneve: “Me i dale zot vetësundimit e tanësisë tokësore të Shqipnisë; Me përdorue çdo miet për me lirue Kosovën e Dibrën e në çdo vend ku flitet shqip e me bashkue nën sundim të Shqipnis së lirë; Në politikë të mbrendshme me i dale zot përparimit e bashkimit kombëtar e në politikë të jashtme me përkrah politikën e atyne shteteve të mdha që diftohen në miqësië me Shqipnië të lire e me idealin e komitetit i cili shkruhet nën nenin I e II”.

¹⁸ *AQSh*, Fondi 246, dos.81, fl.22; *Po aty*, Fondi 246, dos.81, fl.55-57; *po aty*, Fondi 79, dos.36, fl.12. Letër nga Athina e H.Prishtinës, dt. 22 korrik. 1924. Shih edhe T.Abdyli, *vep. e për.*, f.235-236. Më 14 maj 1921 H.Prishtina i kërkoi Këshillit Kombëtar të autorizonte qeverinë “të përkujdeset me randësi të posaçme edhe për ata shqiptarë që ndodhen jashtë Shqipërisë ... në Stambollë, në Rumani, në Kosovë e në Çamëri” dhe në këtë kuadër të ndërmerre aksione diplomatike në arenën ndërkombëtare për të ndaluar terrorin mbi shqiptarët në Jugosllavi, duke formuar një komision parlamentar që të bënte demarshe në Romë, Paris, Londër, Uashington etj.

¹⁹ T.Abdyli, *vep. e për.*, f.232. Dy “varka” me material luftarak, të dërguara nga d’Annuncio i sollë nga Rijeka në limanin e Shëngjinit miku i H.Prishtinës, Dervish Mitrovica në periudhën gusht-shtator 1920.

²⁰ *AQSh*, Fondi 846, dos.57, fl.73-74. Letër e H.Prishtinës, dt. 11 tetor 1921, dërguar nga Roma një bashkohësi mbi ndryshimet që do t’u bëhen sërish kufijve verilindorë të Shqipërisë në favor të Jugosllavisë.

rajonale ballkanike²¹. Kjo i dha peshë edhe hapave diplomatike që ai ndërmoi në gjysmën e parë të viteve 20 dhe veçanërisht pas vitit 1925.

Në këtë kuadër H.Prishtina nuk nënvlerësoi asnjë kombinacion politik që sadopak do të ndihmonte për të afruar drejt zgjidhjes çështjen e Kosovës. Përveç lidhjes së përmendur me d'Anuncion në vitin 1920, për sigurimin e armëve, në këtë kohë evidentohen afrime të H.Prishtinës me lëvizjen nacionaliste bullgaro-maqedone etj., si edhe me lëvizjen e majtë në Jugosllavi e më gjerë, pjesëmarrje në takime e mbledhje të zgjeruara të tyre që planifikonin organizimin e “luftës çlirimtare” e “demokratike” në Jugosllavi, gjithashtu përpjekje për të tërhequr vëmendjen e qarqeve italiane, austriake, bullgare etj. e deri kontakte me përfaqësues të regjimit sovjetik e të Kominternit²².

Prof. A.Baldaçi, më 28 janar 1924, informonte legatën italiane në Tiranë se H.Prishtina kontaktonte në Romë me “ministrin tregtar sovjetik” të akredituar pranë qeverisë italiane, duke u paraqitur si “përfaqësues legal i një komiteti qendror të veprimit shqiptaro-maqedon”, eksponenti kryesor i të cilit ishte Bajram Curri²³. Pak më vonë, më 13 shkurt 1924, sipas njoftimit të Konsullatës së Shqipërisë në Vjenë, H.Prishtina kishte mbërritur në këtë qytet për dy javë, me qëllim të paditur²⁴. Kurse më 22 korrik 1924, ai ndodhej në Athinë, ku, veç të tjerash, orientonte si duhej vepruar për të vënë në lëvizje diplomacinë turke, që të pengohej shpërngulja e shqiptarëve nga Çamëria, e cila ishte vënë përend të ditës nga aktivizimi i marrëveshjes turko-greke për shkëmbimin e popullsive²⁵.

Më 26 shtator 1924, veprimtaria diplomatike e H.Prishtinës shënoi një moment tjetër të rëndësishëm. Kryetarit të Këshillit të Lidhjes së Kombeve iu dërgua nga Gjeneva me firmën e tij, të B.Currit dhe Bedri Pejanit, një

²¹ *Po aty*, Fondi 263, dos.23, fl.44; *po aty*, Fondi 251, dos.69, fl.103. Më 29 nëntor 1923 gazeta italiane “Il nuovo paese”, një muaj pasi kishte mbërritur në Itali për ku ish nisur nga Durrësi më 25 tetor 1923, në një intervistë me të e cilësonte “kreun e opozitës ndaj qeverisë së Ahmet Zogut.

²² T.Abdyli, *vep. e përm.*, f.222. Duke cituar dokumente të arkivave italiane autori informon për pjesëmarrjen e H.Prishtinës në një “Kongres të përfaqësuesve të komiteteve revolucionare të popujve të robëruar”, përkatësisht të përfaqësuesve të minoriteteve në Jugosllavi: maqedonasve, hungarezëve, Italianëve, që duhet të jetë mbajtur në mesin e vitit 1920, i cili aprovoi programin e luftës nacionalçlirimtare në Jugosllavi. Këtë luftë u zotuan ta përkrahnin edhe disa qarqe zyrtare italiane, hungareze e bullgare dhe nga Kominterni. Sipas vendimit të Kongresit revolucionari duhej të fillonte më 15 gusht 1920 në viset e Matit dhe të Dibrës dhe të përhapej në Kosovë, Maqedoni e me ten, duke bashkëpunuar me të majtën jugosllave.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*, Fondi 251, dos.68, fl.3. Njoftim i MP Jashtme, dt. 6 mars 1924, për MP Brendshme lidhur me udhëtimin e H.Prishtinës nga Roma në Vjenë.

²⁵ *Po aty*. Letër e H.Prishtinës nga Athina, dt. 22 korrik 1924.

memorandum në emër të “Komiteteve të Bashkuara të Shqiptarëve të paçliruar”, ku protestohet me fakte për dhunën serbe kundër shqiptarëve.²⁶ Në të, pasi theksohet se “komitetet tona” që më 15-30 tetor 1918, i qenë drejtuar “Konferencës së Paqes, asaj të Ambasadorëve, Lidhjes së Kombeve dhe opinionit publik të botës së qytetëruar” për të protestuar kundër dhunës së shtetit serbo-kroato-sllloven mbi shqiptarët, faktoheshin me të dhëna konkrete veprimet e institucionalizuara të autoriteteve serbe, që prodhonin dhunë e terror, shkatërrime, plaçkitje, shpronësime e kolonizim sllav, shpërngulje masive të shqiptarëve, si edhe mohim të çdo lirie kushtetuese²⁷.

Dy vjet më vonë, veprimtaria e dukshme diplomatike e H.Prishtinës, që sillej rreth e qark Europës, pa u ndalur në përpjekjet e tij në të mirë të zgjidhjes së çështjes së Kosovës, por edhe të ndryshimit të regjimit politik në Shqipëri, shënohet me paraqitjen e një proteste të re në Lidhjen e Kombeve. Protesta e nisur nga Vjena më 15 mars 1927 i drejtohet sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes, sër Erik

Drymond, edhe një herë vinte në dukje gjendjen e mjeruar të shqiptarëve në Jugosllavi²⁸. Në këtë protestë koncize të formuluar me 3 pika, H.Prishtina nënvizonte se Lidhjes së Kombeve, shumë herë i ishin bërë të ditura faktet që provonin gjendjen e dëshpëruar të shqiptarëve atje, megjithatë, asgjë nuk kishte ndryshuar, dhe afro 1 milion shqiptarëve që jetonin në Kosovë e Maqedoni, jo vetëm u qe ndalur arsimi kombëtar, por qeveria po përdorte “të gjitha mënyrat e mundshme për t’i shfarosur” duke i vrrarë e plaçkitur, duke i tatuuar rëndë, duke u “konfiskuar” pasurinë pa kompensim, për t’ua dhënë serbëve e malazezëve, si edhe duke i detyruar të shpërngulen në masë. H.Prishtina i kërkonte Lidhjes së Kombeve dërgimin e një komisioni në Jugosllavi që të shqyrtonte në vend gjendjen e shqiptarëve etj.²⁹ Njëherësh, sikurse konstatohet nga një intervistë dhënë gazetës vjeneze “Neues Vienes Tagblatt”, disa javë pas protestës së përmendur dhe pak më vonë edhe fletores italiane “Giornale d’Italia”, H.Prishtina përpiquej përmes medias masive të ndikonte edhe mbi opinionin publik për gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi, mbi detyrimet e fqinjëve ndaj

²⁶ *Po aty*, Fondi 251, dos.208, fl.1-4; *po aty*, Fondi “Koleksion Fondesh”, dos.35, fl.1-22. Memorandum i “komiteteve të bashkuara të shqiptarëve të paçliruar, dërguar nga H.Prishtina, B.Curri etj. kryesisë së këshillit të Lidhjes së Kombeve. Në memorandum shënoheshin e shtjelloheshin me fakte shtatë pika që dëshmonin për politikën e Beogradit ndaj shqiptarëve: 1. Organizim bandash të armatosura ...; 2. Organizim masakrash periodike ...; 3. Kolonizim i fshatrave të shkatërruara dhe i vatrave të braktisura ...; 4. Plaçkitje të ligjëruara ...; 5. Emigrimi në masë i shqiptarëve të Kosovës ...; 6. Liritë kushtetuese ...; 7. “Drejtësia serbe”...

²⁷ *Po aty*.

²⁸ *Po aty*, Fondi 263, dos.11, fl.1. Protestë e H.Prishtinës, datë 15.3.1927, dërguar nga Vjena Erik Drymondit, sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve.

²⁹ *Po aty*.

Shqipërisë dhe mbi rolin e kësaj të fundit si element stabiliteti në rajon³⁰. I pakënaqur me neglizhencën e Lidhjes së Kombeve, për të marrë në shqyrtim protestën e tij të 15 marsit 1927, me sa duket për shkak të pengesave të Sekretarit të Përgjithshëm Erik Drymondit dhe drejtorit të Sektorit për minoritetet, Kolban-it, H.Prishtina hartoi në Vjenë, në gusht të vitit 1927, një memorandum të ri të detajuar e plotësuar me fakte, si plotësim të protestës së 15 marsit, si edhe mori kontakte të shumta ndër të tjerë, me nënsekretarin e Lidhjes së Kombeve Grandin, dhe me shumë burra shtetesh e delegatë të shteteve të ndryshme në Lidhjen e Kombeve³¹. Por memorandum i sipërpërmendur, që me sa duket u dorëzua në Gjenevë në shtator 1927, hasi pengesa të ndryshme dhe do të shënohej zyrtarisht i pranuar vetëm më 5 prill 1929, datë që edhe u fiksua në dokument³².

Kështu, pikërisht dy vjet pas protestës së 15 marsit 1927, drejtuar E.Drymondit, H.Prishtina i tërhoqi përsëri vëmendjen Lidhjes së Kombeve. Në peticionin e dt. 5 prill 1929, ai protestoi sërish edhe këtë herë në mënyrë mjaft të detajuar, për gjendjen e mjeruar të shqiptarëve në Jugosllavi, duke theksuar se detyrohej “të parashtronte edhe njëherë në mënyrë më konkrete, ankesat kundër trajtimit të shqiptarëve në Mbretërinë Serbo-Kroato-Sllovene”, sepse në përgjigjen e protestës së mëparshme Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, sër Erik Drymond, i kishte bërë të ditur se “karakteri tepër i përgjithshëm i pohimeve që përmbante letra, nuk lejonte që në rastin e saj të përdorej procedura e vendosur nga këshilli për peticionet e pakicave”³³. H.Prishtina edhe një herë në peticionin e 5 prillit të vitit 1929 kërkonte që Lidhja e Kombeve të dërgonte një komision për të shqyrtuar në vend gjendjen e shqiptarëve që jetonin në Jugosllavi dhe të bënte demarshet e duhura për t’u siguruar dhe garantuar shqiptarëve “të drejtat që u njihen pakicave”. “Guxoj të shpresoj, shkruante atdhetari i paepur, se kjo thirrje për shpëtimin e bashkëpatriotëve të mi fatkeqë, nuk do të jehojë në boshllëk ..., çështja që shtroj ... është shumë e madhe edhe për vetë Lidhjen e Kombeve ... [që] ... duhet të provojë se nuk është një institucion i kotë ... por është në shërbim të qytetërimit

³⁰ *Po aty*, Fondi 251, dos.115, fl.4. Deklaratë e H.Prishtinës, dt. 7 prill 1927 dhënë gazetës vjeneze “Neues Vienes Tagblatt”, lidhur me gjendjen e shqiptarëve në Kosovë e Maqedoni; *po aty*, Fondi 251, dos.73, fl.24. Njoftim i MPJ shqiptare, dt. 26 gusht 1927, mbi intervistën e H.Prishtinës dhënë fletores italiane “Giornale d’Italia”

³¹ T.Abdyli, *vep. e për.*, f. 276. Sipas dokumentacionit jugosllav të kohës, të cituar në këtë vepër, H.Prishtina me përkrahjen e Iljaz bej Vronit dhe Xhemil Dinos, delegatëve të Shqipërisë, arriti të merrte pjesë në mbledhjet e Lidhjes së Kombeve.

³² *Po aty*.

³³ *Po aty*, Fondi 251, dos.559, fl.3-8. Peticion i H.Prishtinës, dt. 5 prill 1929, drejtuar në Gjenevë presidentit të Lidhjes së Kombeve për të protestuar për trajtimin e shqiptarëve në Jugosllavi.

e të kulturës. Në qoftë se Lidhja e Kombeve dëshiron të shmangë luftërat, duhet të përpiqet që popujt e shtypur të fitojnë të drejtat e tyre*. Kjo profetizonte H. Prishtina, është rruga e vetme për të bërë që Ballkani të mos jetë më një vullkan i rrezikshëm. Mosplotësimi i kësaj detyre do ta bëjë Lidhjen e Kombeve bashkëfajtores dhe përgjegjëse për një të ardhme që do të jetë e errët dhe kërcënuese³⁴. Dy vjet vonesë për paraqitjen e memorandumit, pesë atentate të dështuara në atë hark kohor, të organizuara nga Beogradi me gjasë në bashkëpunim me Tiranën nuk e kishin ndalur Hasan Prishtinën këmbëngulës, kurse hamendjet në kancelaritë e Romës, Vjenës, Beogradit, Sofjes etj., se kujt po i shërbente ai e kishin marrë përgjigjen. H. Prishtina i shërbente kombit të tij dhe posaçërisht Kosovës³⁵. Në këtë kuadër qëndronte edhe pozicionimi i tij diplomatik, por gjithsesi pozitiv për vlerësimin e Paktit të Dytë italo-shqiptar të Tiranës, që konsiderohej ndër të tjera, goditje për lobin proserb në Shqipëri³⁶. Në fund të fundit ai e kish prezantuar hapur profilin e tij politik në deklaratën “Deri në vdekje”, më 22 maj 1928 në gazetën “Ora e Shqipnisë”³⁷.

Një vit më pas më 18 mars 1930 pasoi një memorandum tjetër i treti në radhë brenda 3 vjetësh i Hasan Prishtinës drejtuar Komitetit të Lidhjes së Kombeve për minoritetet³⁸. Në këtë memorandum adresuar nga Vjena komitetit të Lidhjes së Kombeve, i cili vinte pas konkluzioneve të vaktit të një komisioni (me përfaqësues të Britanisë së Madhe, Persisë dhe Finlandës), të dhëna më 29.XII.1929 dhe pas deklaratave jugosllave se ankesat e shqiptarëve ishin të pabazuara, H. Prishtina duke firmosur si ish-kryeministër, këmbëngulte në vërtetësinë e memorandumeve të dërguara më parë dhe në kërkesën që një “komision hetimor neutral dhe i paanshëm” të dërgohej për të konstatuar gjendjen e vërtetë të shqiptarëve³⁹.

* Sipas dokumenteve nga arkivi jugosllav, cituar nga T. Abdyli, *Hasan Prishtina...*, f. 282, fraza është shënuar: “Nëse Lidhja e Kombeve dëshiron të evitojë luftën në Ballkan, t’i sigurojë liritë minoritetit shqiptar dhe maqedonasve...”

³⁴ *AQSh*, Fondi 251, dos. 559, fl. 3-8.

³⁵ T. Abdyli, *vep. e përm.*, f. 283-284. Qëndrimi i A.Zogut ndaj kundërshtarëve të tij u ashpërsua më vitin 1928 kur u programua së paku një atentat kundër tij.

³⁶ *Giornale d’Italia*, 8. XII.1928; *Ora e Shqipnisë*, 10.I.1928, f. 2/3.

³⁷ *Po aty*, nr.7, 22, viti 1928.

³⁸ *AQSh*, Fondi 251, dos. 149, fl. 234. Memorandumi i H. Prishtinës, dt. 18 mars 1930, drejtuar Lidhjes së Kombeve.

³⁹ *Po aty*; Shih edhe T. Abdyli, *vep. e përm.*, f. 309. Toni më i matur i H. Prishtinës në dy memorandumet e fundit, të gushtit 1927 (paraqitur më 5 prill 1929) dhe 18 marsit 1930, lidhej me situatën e re ndërkombëtare të krijuar pas miratimit të Traktatit të Parisit të 27 gushtit 1928, nënshkruar nga shtetet anëtare të Lidhjes së Kombeve. Sipas këtij Traktati, lufta si mujet për të fituar lirinë dënohej dhe kufijtë shtetërorë mund të rishqyrtohen e të ndryshonin vetëm me bisedime bilaterale të palëve

Keqësimi i situatës deri në nivele të padurueshme për shqiptarët në Jugosllavi pas vitit 1929, si rezultat i koniunkturave ndërkombëtare të krijuara nga kriza globale por edhe si rezultat i vendosjes së diktaturës së gjeneralit Zhivkoviç (me miratimin e mbretit Aleksandër Karagjeorgjeviç) dhe mungesa e veprimeve efikase të Lidhjes së Kombeve për të ndalur dhunën mbi shqiptarët e shtuan në kulm aktivitetin e H. Prishtinës për të nxitur këtë organizëm ndërkombëtar të vepronte në mënyrë të efektshme. Ka mjaft të dhëna që provojnë se Peticioni i njohur i tre klerikëve katolikëve shqiptarë të arratisur nga Jugosllavia pas vrasjes së At Shtjefën Gjeçovit, pikërisht Dom Gjon Bisakut nga Prizreni (famullia i Becit), Dom Shtjefën Kurtit nga Prizreni (famullia e Vovosellës) dhe Dom Luigj Gashi nga Shkupi (famullia e Smaçit), shtetas jugosllavë, misionarë të “Propaganda Fides”, dorëzuar më 5 maj 1930 në Gjenevë Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, Erik Drymondit, ishte projektuar nga H. Prishtina⁴⁰. Ky dokument me shumë argumenta, prej rreth 30 faqesh⁴¹, i paraqitur nga personalitete shqiptare, fetarë të krishterë, që mbështeste kërkesat dhe ankesat e përsëritura të H. Prishtinës dhe diskreditonte përgjigjet zyrtare të Beogradit drejtuar Lidhjes së Kombeve, sikurse pritej bëri bujë, por nuk prodhoi ndonjë masë pozitive sikurse pritej, që do të lehtësonte gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi.

Pasiviteti i përsëritur i Lidhjes së Kombeve e nxiti Hasan Prishtinën që më 10 janar 1931, nga Konstanca e Rumanisë vetëm 10 muaj pas memorandumit të 18 marsit 1930 dhe 8 muaj pas Peticionit të 3 klerikëve t'i dërgonte Lidhjes së kombeve një protestë të re që ngjan me një përmbledhje të Peticionit në fjalë⁴². Thelbi i kësaj proteste ishte në fakt ai i të gjitha këtyre të dërguara më parë. Përveç trajtimit të dhunës, terrorit, shpronësimeve dhe përgjithësisht goditjes ekonomike, kolonizimit sllav dhe shpërnguljes, mungesës së shkollave shqipe etj. H. Prishtina evidentonte edhe persekutimin që u bëhej shqiptarëve katolikë për shkak të fesë, vrasjen e klerikëve të tyre dhe konfiskimin e pronave të komuniteteve fetare. Duke theksuar se Jugosllavia me trajtimin që u bënte shqiptarëve shkelte Traktatin e minoriteteve (artikulli 2), që kishte nënshkruar, ai edhe një herë përsëriste kërkesën për hetimin e çështjes në terren nga një “komision i paanshëm” i Lidhjes së Kombeve⁴³.

Nuk kemi në dorë ndonjë memorandum tjetër për 2 vitet e fundit të jetës së Hasan Prishtinës, të këputur me atentat më 14 gusht 1933 në Selanik. Por të

në konflikt, prandaj H. Prishtina pas kësaj u orientua për të siguruar për çështjen e Kosovës zgjidhje politike në kuadër të veprimtarisë së Lidhjes së Kombeve.

⁴⁰ T. Abdyli, *vep. e përm.*, f. 324.

⁴¹ M. Verli, *Shqipëria dhe Kosova - historia e një aspirote*, Tiranë: 2008, f. 293-323.

⁴² *Gazeta Shqipëria e Re*, Konstancë, 10 janar 1931.

⁴³ *Po aty*.

dhëna të shumta direkte dhe indirekte dëshmojnë se gjatë gjithë periudhës së lëvizjeve jashtë atdheut si mërgimtar politik të viteve 1925-1933 H. Prishtina punoi pa reshtur për sensibilizimin e opinionit publik botëror, të forumeve ndërkombëtare dhe të kancelarive të Fuqive të Mëdha, për çështjen e Kosovës.

Gjatë gjithë kësaj kohe ishte përfaqësues i krahut më radikal të mërgatës politike shqiptare. Natyrisht u angazhua shumë edhe për ndryshimin e pushtetit në Shqipëri, që e konceptonte domosdoshmëri për të zgjidhur çështjen e Kosovës. Shpresonte se për realizimin e këtyre synimeve duhej likuiduar Ahmet Zogu çka përcaktoi bashkëpunimin e tij me anëtarët e organizatës “Bashkimi Kombëtar” të mërgatës politike shqiptare të pas 1925-ës, në atentatin kundër Mbretit në Vjenë më 1931, dhe se në koniunktura të reja përkrahja e Italisë për t’ia shkëputur Kosovën Jugosllavisë nuk do të mungonte. Njëherësh për këtë qëllim, nuk i shkëputi lidhjet, madje disa herë u bë nismëtar i bashkëpunimit me organizatat nacionalçlirimtare maqedone, boshnjake, kroate që gjithashtu luftonin për të flakur zgjedhën serbe⁴⁴. Për veprimtarinë e zhvilluar në këtë kuadër mund të thuhet se H. Prishtina u përpoq për bashkërendimin e luftës së popujve të shtypur të Ballkanit dhe kërkoi respektimin e të drejtave kombëtare të gjithësecilit. Është edhe sot racionale ideja e tij se kjo mund të arrihej me krijimin e shteteve kombëtare dhe me ndërprerjen e çdo forme hegemonie të njërit ndaj tjetrit⁴⁵.

Dihet se për motive politike H. Prishtinës iu bënë katër atentate, dy herë e burgosën pushtuesit serbë e bullgarë dhe gjashtë herë u dënua me vdekje (një herë xhonturqit, një herë E. Toptani, një herë Serbia dhe tre herë regjimi i A. Zogut). Konsekuenca për të mos u ndalur në rrugën e nisur, përcaktoi pikërisht atentatin si mjet për likuidimin e tij. Opinioni mbizotërues konsideron autorë të tij A. Zogun, që në vitin 1933, kur u krye vrasja (14 gusht 1933 në Selanik) i kish keqësuar së tepërmi marrëdhëniet me italianët dhe i trembej rolit të H. Prishtinës për largimin nga fronti apo nga pushteti në Shqipëri, si edhe Jugosllavisë e cila, në koniunkturat e reja që mund të krijoheshin nga ndryshimet politike te fqinji i saj jugperëndimor, shikonte te H. Prishtina një faktor real për rritjen e rrezikut në kufirin e vet shtetëror të atij krahu⁴⁶.

Veprimtaria e dëndur politike, orientimet origjinale të llogaritura e të përcaktuara në interes të zgjidhjes së çështjes së Kosovës, përcaktuan vlerësime të ndryshme për figurën dhe personalitetin politik të H. Prishtinës. Gjithsesi në fund të viteve ‘60 figura e tij ishte rehabilituar dhe në kuadër të vlerësimit konstant pas kësaj, në vitin 1977, eshtrat e tij u sollën me ceremoni zyrtare nga Greqia në Shqipëri.

*

⁴⁴ FESH, vëll.III, 2009, zëri “Prishtina, Hasan”.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty.

* *

DOKUMENTE**Memorandumet dhe protestat e nënshkruara nga H. Prishtina
që iu dërguan Lidhjes së Kombeve****1. Memorandumi i 26 shtatorit 1924**

Gjenevë, më 26 shtator 1924

Zoti kryetar,

Që në ditët e para të rivendosjes së sundimit serb në Kosovë, Maqedoni e mal të Zi (15-30 tetor 1918) komitetet tona i janë drejtuar Konferencës së Paqes, asaj të Ambasadorëve, Lidhjes së Kombeve dhe opinionit publik të botës së qytetëruar për të protestuar kundër këtij regjimi dhe kundër faktorit që shteti serbo-kroato-slloven jo vetëm nuk ka dashur të respektojë të drejtat e minoriteteve, por ka arritur deri aty sa t'u mohojë shqiptarëve të drejtat për të jetuar.

Dokumentet e bashkëngjitura paraqesin një pasqyrë të qëndrimit të serbëve kundrejt shqiptarëve në krahinat e lartpërmendura.

1. Organizim bandash të armatosura:

Nën emrin e organizatave kombëtare, shteti serbo-kroato-slloven ka organizuar banda të armatosura që terrorizojnë krahinat shqiptare, masakrojnë fshatarët pasi u kanë plaçkitur e djegur më parë shtëpitë.

2. Organizim masakrash periodike:

Nën pretekstin e shtypjes së kaçakëve (dezertorëve) forcat e rregullta ushtarake serbe kanë shkatërruar fshatra të shumta në qarkun e Prishtinës, Vuçiternës, Mitrovicës dhe Ipekut duke masakruar me mijëra fshatarë pa kursyer gratë, fëmijët dhe pleqtë.

3. Kolonizim i fshatrave të shkatërruara dhe i vatrave të braktisura

Çdo goditje për shkatërrimin e shqiptarëve pasohet nga një operacion vendosjeje kolonësh rusë, malazez e serbë. Nga ana e tyre këta kolonë terrorizojnë sistematikisht fshatrat fqinjë duke i detyruar banorët të braktisin vatrën dhe tokat e tyre, të cilat konfiskohen dhe kolonizohen menjëherë. Janë pikërisht një pjesë e viktimave të kësaj manevre tragjike, që bredhin rreth vatrave të tyre dhe quhen kaçakë.

4. Plaçkitje të ligjëruara

Kosova vend kryekëput bujqësor... tani vuan nga një mjerim i tmerrshëm i fshatrave dhe qytetarëve me kombësi shqiptare në përgjithësi bujq, u janë marrë tokat me pretekstin e zbatimit të ligjit agrar.

5. Emigrimi në masë i shqiptarëve të Kosovës

Ky regjim i hekurit, i zjarrit dhe i plaçkitjes përbën faktorin kryesor të emigrimit në masë të popullsisë shqiptare në Turqi, i cili po kryhet në kushte të tmerrshme, duke u kushtuar jetën qindra familjeve e duke dënuar pjesën tjetër me një mjerim të patregueshëm.

6. Liritë kushtetuese

Kushtetuta serbe përsa u përket shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë e të malit të Zi nuk ka veçse vlerën e letrave të lyera me ar, për të mashtruar më mirë opinionin

publik të botës së qytetëruar. Ajo është për shqiptarët njëlloj siç ka qenë kushtetuta e xhonturqve e viteve 1908-1918 për armenët.

7. "Drejtësia serbe"

Për të pasur një ide të qartë për "drejtësinë serbe" mjafton të dihet se askush nuk është proceduar në gjyq për mijëra e mijëra krime të kryera në mes të ditës: është i vetmi vend në botë ku bëhen vrasje në prani të gjyqtarëve, të cilët heshtin.

Të tëra këto që parashtruan më lart janë në kundërshtim me normat e përcaktuara në nenet 1 deri 8 të kreut të parë të traktatit për të drejtat e pakicave kombëtare, që është nënshkruar në Sen-Zhermen më 10 shtator 1919 nga fuqitë kryesore aleate dhe shteti serbo-kroato-sloven.

Duke shpresuar se Lidhja e Kombeve do të ketë mirësinë të ndërhyjë pranë Qeverisë së Beogradit për të siguruar zbatimin e traktatit të sipërpërmendur, ne ju lutemi të pranoni ndjenjat e konsideratës sonë të lartë.

Nënshkruar: Bajram Curri, Hasan Prishtina

Përfaqësues të komiteteve të bashkuara të shqiptarëve të paçliruar.

AQSH i RPSSH

Fondi 251, dos. 208, fl. 1-4.

(Origjinali frëngjisht)

*
* *
*

Protestë e Hasan Prishtinës drejtuar sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, sër Erik Drymmond, dt. 15 mars 1927

Shkëlqesi,

Gjendja e dëshpëruar e shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi më shtrëngon t'i drejtohen sërish Lidhjes së Kombeve me lutjen që të merren masa të tjera për të ndihmuar një popull të shtypur e të torturuar.

Faktet, mbi të cilat është bazuar thirrja ime, i janë bërë të ditura shumë herë - dhe me citime të hollësishme - Lidhjes së Kombeve. Ato janë kryesisht si vijon:

1. Afro një milion shqiptarë që banojnë në Kosovë e në Maqedoni nuk kanë as edhe një shkollë në gjuhën e tyre amtare. Po kështu, atyre u është ndaluar të çelin shkolla me mjetet e tyre private.

2. Qeveria e mbretërisë së Jugosllavisë përdor të gjitha mënyrat e mundshme për të shfarosur shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë. Është fakt, është e njohur dhe e qartë që masakrat dhe zhdukja e fshatrave të tëra, vrasjet e shqiptarëve dhe plaçkitja e shtëpive të tyre janë bërë dhe po bëhen sipas urdhrave të agjentëve të autoriteteve më të larta.

3. si pasojë e konfiskimit pa zhdëmtim të pasurisë së bujqve shqiptarë, e cila u është ndarë serbëve dhe malazezëve, shqiptarët janë shtrënguar të braktisin në masë vendin e tyre, truallin e të parëve të tyre. Shqiptarët myslimanë e katolikë duhet të paguajnë taksa 60% më të larta, masë kjo e marrë për t'i rrënuar ekonomikisht e, në këtë mënyrë, për t'i detyruar të emigrojnë.

Lutemi që Lidhja e Kombeve të caktojë një komision të paanshëm me detyrë që të shkojë në Jugosllavi dhe të shqyrtojë në vend gjendjen e pakicës shqiptare atje, duke i parashtruar lidhur me këtë një raport Lidhjes së Kombeve.

AQSH I RPSSH
Fondi 263, dos. 11, fl. 1.
(Kopje frëngjisht)

*
* *
*

**Peticion i Hasan Prishtinës drejtuar presidentit
të Lidhjes së Kombeve dt. 5 prill 1929**

Gjenevë, më 5 prill 1929

Zotit president të Lidhjes së Kombeve

në Gjenevë

Me letërën time të 15 marsit 1927 i lejoja vetes të parashtroj para Lidhjes së Kombeve disa ankesa të shqiptarëve që banojnë në mbretërinë e serbëve, kroatëve e sllovenëve dhe të tërheq vëmendjen e saj për faktin e vajtueshëm të shqiptarëve në shtetin e lartpërmendur, të cilët arrijnë shifrën një milion, gjë që kapërcen edhe numrin e banorëve të vetë Shqipërisë së Pavarur, janë në mbretërinë e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve të privuar nga çdo e drejtë që marrëveshjet ndërkombëtare e parime e njerëzimit u njohin pakicave kombëtare.

Zoti sekretar i përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, sër Erik Drymond, më bëri të ditur, në përgjigjen e tij të 15 prillit, që karakteri tepër i përgjithshëm i pohimeve që përmban letra ime nuk lejon që në rastin e saj të përdoret procedura e vendosur nga këshilli për peticionet e pakicave.

I lejoj vetes pra, për pasojë, të parashtroj edhe një herë, në një mënyrë më konkrete, ankesa kundër trajtimit që i janë nënshtruar bashkatdhetarët e mi shqiptarë në mbretërinë e serbo-kroatëve e sllovenëve.

Pakica shqiptare në shtetin serbo-kroato-slloven është e shtypur. Prova më e dukshme është se në këtë shtet një milion shqiptarë jetojnë pa pasur asnjë shkollë shqipe.

Ky fakt dëshmon më tepër se kushdo që qeveria e shtetit serbo-kroato-slloven është në rrugën e zhdukjes së kombit shqiptar brenda territorit të vet.

Në kushtet kur në Jugosllavi rinia shqiptare nuk mund të arsimohet në gjuhën amtare, asaj i mbeten vetëm dy rrugë: ose të humbasë kombësinë, ose të heqë dorë nga arsimimi. Këto dy mundësi janë aq të dhimbshme dhe fatale për të ardhmen e kombit tonë sa indinjojnë Evropën, në kufijtë e së cilës gjendet kombi ynë. Është Evropa, është instanca e saj më e lartë, së cilës nëpërmjet meje, shqiptarët i drejtojnë britmën e tyre ...

Po kështu, në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe kombëtare qeveria e shtetit serbo-kroato-slloven vepron në bazë të të njëjtave parime, duke ndjekur hapur rrugën e zhdukjes së kombit tonë.

Shqiptarët e Kosovës, si edhe ata të territoreve të tjera të banuara prej tyre në shtetin serbo-kroato-slloven janë, në pjesën dërrmuese, bujq të ngulur denbabaden. Me një aftësi dhe me një zell të njohur nga të gjithë shkencëtarët e huaj, ata punojnë tokën e trashëguar nga të parët dhe janë të lidhur me një dashuri të zjarrtë me këtë tokë e me

vatrën e tyre. Me anë të dhunës të të gjitha llojeve, duke marrë nëpër këmbë të drejtat e personit dhe të tërë kombit shqiptar, qeveria e shtetit serbo-kroato-sloven e trajton këtë popull të rrënjosur në tokën e tij siç trajtoheshin në kohërat e largëta të lashtësisë fiset e mundura dhe të skllavëruara: shqiptarët janë dëbuar nga tokat e tyre, nga trualli i tyre aq i dashur stërgjyshor, i vaditur me gjakun dhe djersën e tyre, ata janë të shtrënguar të braktisin atë, të emigrojnë në Turqi e në vende të tjera të kontinentit, të jetojnë në mjerim, pa strehë dhe pa atdhe, të privuar nga çdo e mirë, ndërkohë që qeveria serbo-kroato-slovene e ndan pasurinë e tyre në mes të serbëve, malazezëve dhe emigrantëve rusë.

Është kjo arsyeja që në vendin tonë të shumëdashur, në truallin e punuar prej të parëve tanë, të cilit ne i kushtuam forcat e rinisë sonë, e mbrojtëm atë në shekuj kundër armiqve të kombit tonë, është kjo arsyeja që në shekullin e përparimit dhe të humanizmit vazhdon fati tragjik i një populli fatkeq, i cili, në dhembjen e vet, i drejtohet Lidhjes së Kombeve duke iu lutur për ndihmë dhe përkrahje.

Atë që nuk e arriti dot dhuna, qeveria e shtetit serbo-kroato-sloven e kreu me anë të administratës së vet, duke shtypur sistematikisht popullsinë shqiptare nëpërmjet autoritetit dhe organeve të saj.

Është e pamundur për një shqiptar të ngrejë padi për të drejtat e veta para një gjyqi serb. Qeveria i heq qafe politikanët shqiptarë të padëshirueshëm, duke i dënuar sado të pafajshëm me afate të gjata burgimi.

Aktet e dhunës dhe të terrorit, madje edhe vrasjet në mes të popullsisë shqiptare nuk ndiqen ligjërisht, edhe atëherë kur drejtësia i njeh autorët e tyre.

Kështu shqiptari Nazim Gafuri, ish-deputet i Skupshtinës, u plagos në një pusi në Belgrad; në Prishtinë u vra barbarisht anëtari shqiptar i këshillit bashkiak të qytetit Jusuf Ahmeti. Vrasësit e tyre nuk u ndoqën ligjërisht, megjithëse emrat e tyre ishin të njohur nga ana e autoriteteve. Të gjithë autoritetet dhe organet e tyre, e në radhë të parë gjindarmët e plotfuqishëm, marrin pjesë aktive në luftën e pamëshirshme të shfarosjes që zhvillohet kundër popullit tonë. Në mënyrë të fshehtë e të hapur ata mbështesin aktet e bandave të kriminelëve serbë që sulmojnë fshatrat, grabisin e vrasin.

Administrimi i taksave dhe i kontributeve bëhet në të njëjtën mënyrë. Taksat më të rënda u vihen arbitrarisht shqiptarëve, me qëllim që të shkaktohet shkatërrimi i tyre ekonomik dhe për të çuar në varfëri njerëz që më parë ishin të mëkëmbur.

Liria e shtypit. Kjo shtyllë e të drejtave të njeriut nuk ekziston për shqiptarët në shtetin serbo-kroato-sloven. Të gjitha gazetat shqiptare janë të ndaluara dhe ky popull martir nuk ka madje as të drejtën të lëshojë një rënkim dhimbjeje.

Gjatë zgjedhjeve të fundit qeveria jugosllave shtypi me mjete me të vërtetë barbare lëvizjen elektorale shqiptare. Autoritetet e çdo shkalle, xhandarët dhe banditët më të rrezikshëm u vërsulën mbi zgjedhësit shqiptarë.

Pasojat e terrorizmit të ushtruar gjatë zgjedhjeve janë: vetëm gjashtë deputetë do të përfaqësojnë në Skupshtinë një milion shqiptarë. Gjendja e shqiptarëve në shtetin serbo-kroato-sloven nuk mund të krahasohet me gjendjen e cilëndo pakicë kombëtare në cilindo vend të Evropës.

Në çdo shtet tjetër jeta e personit është të paktën e siguruar, ka një ligj, që duke i vënë detyra, i jep gjithashtu edhe të drejta.

Shqiptari në shtetin serbo-kroato-slloven është jashtë ligjit. Aty mbretëron tirania arbitrare që ka për qëllim të zhdukë atë dhe kombin e tij. Grushti i një xhandari vlen më shumë se ligji.

Me luftën për të drejtat e tyre dhe për drejtësi, për gjuhën e tyre, për të ardhmen e tyre, për jetën e tyre të kërcënuar, për fushat e të parëve të tyre, për ekzistencën e tyre kombëtare, shqiptarët, të cilët fati i keq i ka dënuar të jetojnë nën zgjedhën serbe, i drejtohen Lidhjes së Kombeve si një mishërim i Evropës së qytetëruar, dhe i bëjnë asaj këtë lutje:

- që Lidhja e Kombeve, me anë të një komisioni të paanshëm të shqyrtojë në vend gjendjen e shqiptarëve që jetojnë në shtetin serbo-kroato-slloven dhe të bëjë hapat e nevojshëm për t'i siguruar këtij populli të shtypur e të përndjekur gëzimin e të drejtave që u njihen pakicave.

Në emër të bashkatdhetarëve të mi fatkeqë që jetojnë në shtetin serbo-kroato-slloven i parashtrij këtë lutje Lidhjes së Kombeve dhe guxoj të shpresoj që kjo thirrje për shpëtimin e bashkëpatriotëve të mi fatkeqë nuk do të jehojë në boshllëk.

Zoti kryetar, çështja që shtroj unë në këto radhë është e një rëndësie shumë të madhe edhe për vetë Lidhjen e Kombeve. Është fjala këtu për t'i shërbyer çështjes së madhe të njerëzimit dhe të paqes, është fjala këtu për të shmangur luftërat, këta kamxhikë të njerëzimit. Për këtë Lidhja e Kombeve duhet të provojë se nuk është një institucion i kotë, sa për t'u dukur, por është në shërbim të qytetërimit e të kulturës. Në qoftë se Lidhja e Kombeve dëshiron të shmangë luftërat, duhet të përpiqet që popujt e shtypur të fitojnë të drejtat e tyre. Kjo është rruga e vetme për të bërë që Ballkani të mos jetë më një vullkan i rrezikshëm. Mosplotësimi i kësaj detyre do ta bëjë Lidhjen e Kombeve bashkëfajtores dhe përgjegjëse për një të ardhme që do të jetë e errët dhe kërcënuese.

Zoti kryetar, ju drejtohem juve dhe kolegëve tuaj të ndritur: mos harroni se çështja e pakicave është problemi më i rëndësishëm i epokës së sotme. Mos harroni se një zgjidhje e goditur mund të sigurojë paqen në Evropë dhe të mbulojë me lavdi flamurin e Lidhjes së Kombeve.

Shfrytëzoj rastin për t'i shprehur Lidhjes së Kombeve ndjenjën e konsideratës sonë më të devotshme.

Hasan Prishtina

AQSH i RPSH
Fondi 251, dos. 559, fl. 3-8
(Kopje frëngjisht)

*
* *

**Memorandum i Hasan Prishtinës drejtuar komitetit
të Lidhjes së Kombeve dt. 18 mars 1930**

Vjenë, më 18 mars 1930

Shkëlqesi,

Duke iu referuar memorandumit tim paraqitur së lartës Lidhje të Kombeve, më 15 mars 1927- J. Z. 41-58664-11379, kam nderin të deklaroj si përfaqësues i shqiptarëve, që jetojnë në territorin e mbretërisë së Jugosllavisë, dhe në emrin e tyre, sa vijon:

Qeveria mbretërore jugosllave ka deklaruar se ankesat tona janë të pabazuara sepse shqiptarët në Jugosllavi gëzojnë liri të plotë, kanë shkolla dhe ushtrojnë të drejtat politike. Këto deklarata nuk i përgjigjen aspak fakteve.

Përkundrazi, e vërteta është se në tërë Jugosllavinë nuk ka asnjë shkollë shqiptare, se elementi shqiptar kudo në vendin e sipërpërmendur është i shtypur dhe se shqiptarët janë zhveshur bile nga pronat e tyre, që u janë shpërndarë serbëve, malazezëve dhe rusëve.

Prandaj ne shqiptarët e krahinës së Kosovës i lutemi të lartit komitetit të ketë mirësinë të bindet për vërtetësinë e ankesave tona, duke dërguar një komision hetimor neutral dhe të paanshëm në vendin në fjalë.

Një pakicë prej një milion vetash kërkon ndihmë në luftën për ekzistencën kombëtare.

I larti komitet, duke vepruar, do të ketë mirënjohjen e zjarrtë të një pakice të kërcënuar me vdekje.

I lutem shkëlqesisë suaj të ketë mirësinë të mirëpresë shprehjen e devotshmërisë sime më të lartë.

Hasan Prishtina
Ish-kryeministër shqiptar

AQSH i RPSSH
Fondi 251, dos.194, fl. 234.
(Kopje frëngjisht)

*
* *

Protestë e Hasan Prishtinës drejtuar Lidhjes së Kombeve dt. 10 janar 1931

Konstancë, më 10 janar 1931

Gjendja e mjeruar e shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi më detyron sërish t'i drejtohem Lidhjes së Kombeve me lutjen të përkrah një popull të shtypur dhe të torturuar jashtë masës.

Faktet me të cilat mbështetet thirrja ime prej kohe i janë komunikuar hollësisht Lidhjes Kombeve. Syresh kryesore janë këto që pasojnë:

1. Pothuaj 1.000.000 shqiptarë që banojnë në Kosovë dhe Maqedoni nuk kanë asnjë të vetme shkollë në gjuhën e tyre amtare. Gjithashtu kanë qenë dhe janë të ndaluar të çelin shkolla me mjetet e veta.

2. Qeveria e Mbretërisë jugosllave përdor gjithë masat e mundëshme për t'i shuajtur shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë. Është fakt i vërtetuar se fshatra të tëra janë masakruar. Shqiptarët janë vrarë dhe shtëpitë e tyre janë djegur me urdhërin e autoriteteve eprorë.

3. Duke u konfiskuar pa pagesë pronat e bujqëve shqiptarë, të cilat u janë ndarë serbëve dhe malazezëve, shqiptarët mohamedanë e katolikë janë të detyruar të braktisin atdheun e tyre, tokën e prindërve të tyre, të paguajnë tagrat shtetnore me 60 përqind më tepër dhe kjo masë përdoret që t'i shkatërrojë ekonomkisht dhe t'i shtrëngojë të emigrojnë.

Një përfundim i kësaj mënyre trajtimi të shqiptarëve është që popullsia serbe e qarkut të Gjakovës e cila, përpara dhjetë vjetësh, nuk prekte as një përqind të popullsisë, sot arrin në njëzet përqind, kurse njëzet përqind e popullsisë autoktone u largua nga tokat e saj.

4. Qeveria jugoslave persekuton shqiptarët katolikë për shkakun e fesë. I shtrëngon këta shqiptarë të neveritin fenë e tyre dhe kombësinë e tyre. Priftërinjtë e tyre janë vrarë prapa krahëve gjithë për këtë shkak. Qeveria konfiskon pronjat e komuniteteve fetare.

Këto janë disa nga veprat e mbretërisë jugosllave: vepra të drejtuara kundra të drejtave të njeriut.

Artikulli 2 i Traktatit të minoriteteve thotë: "Shteti SKS e merr përsipër t'u akordohej gjithë banuesve përkrahje të plotë për jetën e tyre dhe për lirinë e tyre, pa ndryshim kombësie, gjuhe, race ose feje".

Mënyra se qysh janë trajtuar shqiptarët që rrojnë brenda kufijve të mbretërisë jugosllave, jo vetëm që është në kundërshtim me çdo fjalë të këtij traktati, por na kujton mënyrën se si kanë qenë trajtuar robët në mesjetë. Për këtë shkak në emër të bashkatdhetarëve të mij, të shqiptarëve të Kosovës e të Maqedonisë, i luten së Naltës shoqëri të Kombeve t'i vijë në ndihmë një populli aq padrejtërisht të torturuar.

Qeveria Jugoslave zgjodhi metodën e mohimit të plotë ndonëse aq qarje e aq thirrje janë formuluar kundra sajë. Gjithë ajo qeveri mohon edhe faktin e pa kundërshtueshëm se 1.000.000. shqiptarë nuk kanë në Jugosllavi as një të vetëm shkollë shqipe.

Përpara kësaj taktike përsërit lutjen që kam bërë më para.

Që shoqëria e Kombeve të emroj një komision të paanshëm i cili të shkojë në Jugosllavi e të hetojë në vend gjendjen e minoriteteve shqiptare në jugosllavi dhe t'i paraqitet një raport shoqërisë së Kombeve.

I lutem shkëlqesisë s'uj të pranojë shprehjen e konsideratës s'ime ...

Hasan Prishtina

"Shqipëria e Re"

Konstancë, më 10 janar 1931

